

DOKUMENTI KONSULTATIV

Për projektligjin “Për Shitjen e Pasurive të Paluajtshme Shtetërore Poseduesëve Faktikë Jopronare në Zonat me Përparësi Zhvillimin e Ekonomisë Malore”

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit në kuadër të procesit të konsultimit “Për projektligjin “Për Shitjen e Pasurive të Paluajtshme Shtetërore Poseduesëve Faktikë Jopronare në Zonat me Përparësi Zhvillimin e Ekonomisë Malore” mirpret sugjerimet nga qytetarët, ekspertë të fushës, nga të gjitha institucionet dhe subjektet e interesuara, organizata jofitimprurëse, shoqëria civile, të drejtat ose objekti i veprimtarisë të të cilave ka të bëjë apo ndikohet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo nga përcaktimet e kësaj nisme.

Kohëzgjatja e konsultimeve:

Konsultimet në portalin e Regjistrimit Elektronik: 20 ditë pune, duke filluar nga data 18.9.2024 16.10.2024.

Si të përgjigjeni:

Kontributet që në kuadër të procesit të konsultimit dhe përmirësimit të përmbajtjes së projektligjit, do të përcillen nga institucionet e interesuara me anë të regjistrimit elektronik në adresën <http://www.konsultimipublik.gov.al>.

Kontakti:

Eriola Jençeri, Koordinator për konsultimin publik në Ministri: eriola.kocileri@meki.gov.al

Eralda Shtylla : eralda.shtylla@meki.gov.al

Datat dhe vendet e takimeve publike:

E-Konsultimi: në portalin “Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike” 20 ditë pune, duke filluar nga data 18 shtator 2024.

Sfondi i propozimit legjislativ

Projektligji “Për Shitjen e Pasurive të Paluajtshme Shtetërore Poseduesëve Faktikë Jo pronarë në Zonat me Përparësi Zhvillimin e Ekonomisë Malore” (në vijim Projektligji) ka për qëllim, të japë zgjidhje ligjore, një specifike që paraqet situata aktuale me pasuritë e paluajtshme shtetërore, në zona rajonale/lokale të qeverisjes vendore, që konsiderohen si zona të një rëndësie të veçantë me përparësi zhvillimin. Poseduesit faktikë të këtyre pasurive të paluajtshme, i posedojnë ato në mungesë të titujve të pronësisë, ose në mospërputhje me titujt e pronësisë që zotërojnë. Mungesa e titujve të pronësisë të regjistruar sipas kërkesave ligjore në fuqi, përbën një sfidë, të cilës synohet që përmes këtij projektligji, t’i jepet një zgjidhje ligjore, e qëndrueshme, në përputhje me parimet themelore të mbrojtjes së të drejtës së pronësisë dhe një procesi të rregullt dhe ligjor.

Propozimet

Ky projektligj ka si përparësi dhe efekte të pritshme:

Konsolidimin e marrëdhënies juridike të pronësisë mbi tokën, në zonat me përparësi zhvillimin.

Nxitjen dhe tërheqjen e investimeve për zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë, në ato zona , të cilat për shkak të burimeve natyrore, trashëgimisë së pasur kulturore dhe gamën e gjerë të aktiviteteve në natyrë që ofrojnë konsiderohen si zona të një rëndësie të veçantë me përparësi zhvillimin malor dhe kanë nevojë për mbështetje të posaçme me qëllim rimëkëmbjen ekonomike, nxitjen e punësimit, përmirësimin e kushteve të jetesës.

Shfrytëzimin me efikasitet të burimeve të natyrës, mbrojtjes së ekosistemit dhe vlerave territoriale.

Pyetjet

Reagimet që priten janë të hapura dhe nuk parashikohet ngritja e pyetjeve specifike, të cilat kërkojnë përgjigje. Pyetje të mundshme mund të jenë: A pajtoheni me qartësinë e informacionit të paraqitur ne dokument dhe çfarë do të propozonit shtesë për të përmirësuar cilësinë e tij? Si i vlerësoni përcaktimet në këtë projektligj.